



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHOQËRIA “ALBPETROL” SH.A.

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Patos, më \_\_\_/07/2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Punë**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Përmirësimi, digjitalizimi dhe rikualifikimi i infrastrukturës të stacionit të shitjes së naftës Zharrëz, Q.A.SH.N.G. Patos”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45210000-2-punime ndertimi

VLERA E FONDIT LIMIT: 419,717,688.26 (katërqind e nëntëmbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tetë presje njëzet e gjashtë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Albpétrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1*
- d. *Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkesat e mesiperme janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet tatimore dhe ato të energjisë elektrike sipas percaktimeve të legjislacionit përkatës.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit te ofertes eshte detyrim ligjor i percaktuar nga legjislacioni ne fuqi mesipercituar, si nje mjet garancie per AK ne rast te terheqjes se ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimit të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së percaktuar në dokumentet e tenderit.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

2.1.1. Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriterëve të përgjithshme të pranimit/ kualifikimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është percaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, pika 2 gwrma "b" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". ku percaktohet se: "Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar"

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është "E Hapur – Punë Publike - ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar – Prokurim publik me mjete elektronike", përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma "b" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku percaktohet se: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar"

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku percaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve. të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor,

organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në Nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” citohet se “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është kërkuar duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh;** ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh;** iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar gjatë periudhës kontabël**".*

## **Aftësitë teknike dhe profesionale:**

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale përsa i përket aftësisë teknike e profesionale

2.3.1. Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin :

- a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 200,000,000 (dyqind milion) leke pa tvsh dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se 800,000,000 (teteqind milion) leke pa tvsh.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve, (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore përkatëse.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet te paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë ne nje vlere jo me te madhe se 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo me shume se sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:* Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar me sukses kontratën objekt prokurimi, sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Në mbështetje të Nenit 88, pika 3 e VKM 285/2021, parashikon se: *“Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht”.*

Në mbështetje të Nenit 88, pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve”.*

Pra në rastet e BOE, dokumentacioni i kërkuar për të vërtetuar përvojën e mëparshme si kontrata e bashkëpunimit, disponohen nga çdo OE në rastin kur ka qenë palë në Bashkimin e OE. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që ka çdo shoqëri në dosjen e saj në rastin kur ka qenë në atë status, e për rrjedhojë nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore të prokurimit publik dhe nuk sjell asnjë kufizim të pjesëmarrjes së OE në procedurën e prokurimit në fjalë.

Kriteret e mëposhtme teknike nga pika 2.3.2 dhe ne fund janë propozuar dhe vendosur nga specialistët e fushës inxhinierë, pjesë e njësisë së prokurimit, sipas përcaktimit të nenit 74, dhe 78 të VKM nr. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik si dhe

njoftimit nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi organizmin e Procedurave të Prokurimit Publik”.

**2.3.2. Operatori ekonomik duhet të disponojë license projektimi, mund të nenkontraktoje shërbimin e projektimit, ose të paraqesë kontratë bashkëpunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit, të licensuar sipas rregullores së miratuar me VKM nr. 943, datë 28/12/2016 ” Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim ”** Licensa e projektimit duhet të ketë kategorite si më poshtë :

A.

**Kat.2 Projektues Arkitekt** a) Projektim arkitekturor për objekte banimi-objekte industriale-objekte turistike; d) Projektim paisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelberta, lulishte e parqe.

**Kat. 3 Projektues Kontruktor** a) Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate. b) objekte vivile industriale-turistike mbi 5 kate-2objekte me skelet metalik c) objekte me shkallë të lartë veshitëse betoni d) Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe performancimi i strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.

**Kat.4 Projektues Instalator** a) Projektim të instalimeve hidro-termosantare; b)Projektim të instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme, c)Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale; e) projektim të sistemeve të furnizimit me gaz. f) Projektim të sistemeve kundër zjarrit.;g)Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtësi)Projektim i ndërcimit rrugor, shesheve,dekorativ, ndërcimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroportive etj,

j) Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, akses kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile dhe industriale

**Kat.5 Projektues vepra hidraulike** b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

**Kat.8 Projektues Gjeodet** a) Rilevime inxhinierike, b) Rilevime inxhinierike kadastrale, d) Bazamente Gjeodezike

**Kat.9 Studim gjeologjik inxhinierik-hidrogeologjik** a) Studim/vlerësim gjeologjik-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.

B.

Për realizimin e shërbimit të projektimit; Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij :

- 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- 1 (nje) Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë për të kryer auditime në instalime industriale.
- 1 (një) Ekspert Zjarrëfikës; për kategorinë B. “Hartimi i projekteve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”
- 1 (një) Inxhinier i pajisur me certifikatën e lejes profesionale për veprimtari studimore-projektuese dhe zbatuese në aktivitetin e përpunimit, transportimit, depozitimit dhe tregtimit të lendeve hidrokarbure Kat. b3

**Per stafin e mesipër duhet të paraqiten:**



- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit të lartë
- Licencat profesionale

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e inxhinierëve dhe punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. Nr. 943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, “për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”. Kështu më konkretisht sipas Termave të referencës dhe specifikimeve teknike, paraqiten nevojat e projektimit si më poshtë:

<i><b>Kategoria e projektimit</b></i>	<i><b>Fushat e studimit</b></i>	<i><b>Argumentimi teknik</b></i>
Kat. 2 Projektues Arkitekt	a)Projektim arkitekturor për objekte banimi-objekte industrial-objekte turistike; d)Projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelberta, lulishte e parqe.	Fusha e studimit a) është përzgjedhur duke u nisur nga nevoja e përpilimit të një projekti arkitekturor nga OE për rregullimin e stacionit të shitjes në Zharrëz, që klasifikohet si objekt industrial. Fusha e studimit d) është e nevojshme pasi në stacionit e Zharrëz ekzistojnë sipërfaqe të patrajtuar të cilat duhet të nënshtrohet një projekti rregullimi me sipërfaqe të gjelbërt.
Kat. 3 Projektues Kontruktor	a) Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate. b) objekte vivile industrial-turistike mbi 5 kate-2objekte me skelet metalik c) objekte me shkalle të lartë veshitësie betoni d) Vlerësimi i kapacitetit mbajtës dhe perforecimi I strukturave mbajtëse prej beton-arme, murature dhe metalike.	Fusha e studimit a) lidhet me kërkesën e AK që të rikonstruktohet godina administrative e stacionit të shitjes, b) lidhet me kërkesat për ndërtimin e depozitave me konstruksion metalik, strukturat metalik të stacionit të ngarkimit dhe të pompave si dhe strukturave të

		<p>tjërave të nevojshme për tu realizuar në objektin e prokurimit. Fusha e studimit c) lidhen me kërkesat e objektit të prokurimit për realizimin e argjinaturave/vaskave të avarive rreth depozitave të naftës bruto, grupës teknologjike e themeleve të depozitave të naftës ku të gjitha këto do të realizohet me struktura beton/arme, ndërsa fusha e studimit d) lidhet me kërkesën e AK për ndërhyrjet strukturore në të gjitha depozitat ekzistuese për përshtatjen e tyre me tubacionet teknologjike të reja që do të realizohen sipas objektit të prokurimit. Për më tepër do të vlerësohen sheshet ndërtimore ekzistuese dhe rrugët ekzistuese.</p>
<p>Kat.4 Projektues Instalator</p>	<p>a) Projektim te instalimeve hidro-termosantare; b)Projektim te instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe te impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme, c)Projektim te linjave e rrjeteve elektrike, per objekte civile e industriale; f) Projektim te sistemeve kundra zjarrit.;g)Projektim te sistemeve te monitorimit dhe automatizimit ne industri dhe ndërtesa i)Projektim i ndricimit rrugor, shesheve,dekorativ, ndricimit te objekteve te medha sportive, porteve aeroporteve etj,</p> <p>j) Projektim te rrjeteve te telefonise, citofonise, fonise, internetit, TV, access kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit te zjarrit, etj., per objektet civile dhe industriale</p>	<p>Fusha e studimit a) dhe b) lidhet me kërkesat e projektimit ndaj OE, për të zhvilluar sistemet mekanike të nevojshme në godinat administrative që do të rikonstruktohen. Fusha e studimit c) lidhen me kërkesat e objektit të prokurimit për rregullimin e linjave të rrjetit elektrik ekzistues dhe përshtatjen e tij me nevojat e reja të stacionit të shitjes. Fusha e studimit f) lidhet me sistemin e ri kundra zjarrit që duhet të projektohet nga OE, pasi një i tillë mungon në stacionit e Zharrëzës. Fusha e studimit g) lidhet me kërkesat e objektit të prokurimit për projektimin e sistemit të sigurisë perimetrale dhe monitorimin volumetrik të depozitave në stacion. Fushat e studimit i) dhe j) ndërlihen me nevojat e objektit të prokurimit</p>



		për projektimin e sistemeve të ndriçimit perimetral të stacionit dhe projektimit e sistemeve ndihmëse të sigurisë perimetrale.
Kat.5 Projektues vepra hidraulike shkarkimi.	b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë	Ndërlidhet me kërkesën e AK, për rregullimin e rrjetit ekzistues të furnizimit me uji, ndarjes së ujrave të shiut me ato teknologjike, të cilat janë aktualisht të lidhur në një sistem.
Kat.8 Projektues Gjeodet	a) Rilevime inxhinierike, b) Rilevime inxhinierike kadastrale, d) Bazamente Gjeodezike	Objekti i prokurimit ka nevojë për një azhornim sa më të ri të rilevimit si dhe për shkak të nevojës për leje është i nevojshëm dhe rilevimi inxhinierik kadastral i tij.
Kat.9 Studim gjeologo inxhinierik-hidrogeologjik	a) Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile – ekonomike deri 5 kate.	Studimi i gjeologo-inxhinierik paraqitet si kërkesë nga AK, për të vlerësuar gjendjen aktuale të truallit përpara ndërtimit të strukturave të reja që paraqiten në objektin e prokurimit.

- 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

**Argumentimi:** Në përputhje me kërkesën e ligjit Nr. 10440 të dt. 07.07.2011 “Për Vlerësimin e ndikimit në mjedis” - VNM është i detyruar gjatë fazës së dorëzimit të projektimit për leje të rikonstruksionit të stacionit. Në këto kushte, personi përgjegjës për zhvillimin e këtij raporti paraprak janë individët e certifikuar nga ministria, si ekspertë të VNM-së dhe auditimit mjedisor.

- 1 (nje) Auditues energjetik i Certifikuar nga Agjensia per Eficensen e Energjise per te kryer auditime në instalime industriale

**Argumentimi:** Duke u nisur nga kërkesa e AK, për përgatitjen e raportit/studimit të auditimit energjetik për instalime industriale, personi përgjegjës për realizimin e këtij studimi duhet të jetë i certifikuar nga Agjensia për Eficensën e Energjisë, në përputhje me Vendim nr. 407, data 19.6.2019 “për kushtet dhe kërkesat e certifikimit të audituesit të energjisë” e Ligjit Nr. 124/2015 “PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË”.

- 1 (një) Ekspert Zjarrëfikës Privat për kategorinë B. “ Hartimi i projekteve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”

**Argumentimi:** Sipas udhëzimit Nr. 81, datë 6.3.2020 “PËR KLASIFIKIMIN E OBJEKTEVE, SIPAS RREZIKSHMËRISË NGA ZJARRI, PROCEDURAT E SHQYRTIMIT DHE TË MIRATIMIT TË PROJEKTIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN, SI DHE DHËNIA E CERTIFIKATËS SË SIGURISË NGA ZJARRI.” Projektuesi i angazhuar në realizimin e projekteve të mbrojtjes nga zjarri duhet të jetë një ekspert zjarrëfikës i certifikuar sipas kategorisë B. “ Hartimi i projekteve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

- 1 (një) Inxhinier i pajisur me certifikatën e lejes profesionale për veprimtari studimore-projektuese dhe zbatuese në aktivitetin e përpunimit, transportimit, depozitimit dhe tregtimit të lëndëve hidrokarbure kat. b3

**Argumentimi:** Bazuar në Ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe VKM nr. 551, dt. 18.06.2015 “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure”, për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese në aktivitetin e përpunimit, transportimit, depozitimit dhe tregtimit të lëndëve hidrokarbure, projektuesi duhet të posedojë certifikatën B.3. “Certifikata si projektues, konsulent, kolaudues për aktivitetin e transportimit, depozitimit dhe tregtimit të lëndëve hidrokarbure”.

2.3.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”. të ndryshuar, në përputhje me zërat e punimeve që përfshihen në preventivin e punimeve, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- **NP-1 A** Punime germimi në tokë
- **NP-2 E** Ndërtime civile dhe industriale
- **NP-3 A** Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industrial, veshje fasada
- **NP-4 B** Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- **NP-7 A** Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje
- **NP-12 A** Punime të inxhinierisë së mjedisit
- **NS-1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **NS-4 A** Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me të rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese etj
- **NS-6 A** Sinjalistike rrugore jo ndricuese
- **NS-8 A** Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
- **NS -12 A** Impiante teknologjike, termik dhe të kondicionimit

- **NS-14 A** Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radoitelefoni TV etj
- **NS-18 A** Punime topogjeodezike

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, ku Neni 8 përcakton se: "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane” si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.1 ku përcaktohet se: “Çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi, vetëm në klasat dhe kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në licencë.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që Ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban Preventivi për cdo zë pune mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë objekt prokurimi.

2.3.2 Staf i kryesor e mbështetës, punonjësit, licencimet, çertifikimet.

Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij si drejtues teknik të shoqërisë minimalisht inxhinierët e mëposhtëm:

- Inxhinier Ndertimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Topograf 1 (një)
- Inxhinier Elektronik 1 (një)

- Inxhinieret e sipercituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë minimalisht në 3 muajt e fundit.

**Për secilin inxhinier drejtues teknik duhet të paraqiten:**

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit të lartë.
- Listëpagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit në të cilat inxhinieret e sipërpermendur duhet të figurojnë.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e inxhinierëve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

**Argumentimi:** Kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, termat e referencës specififikimet teknike dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi i inxhinierëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Referuar preventivisht të Punimeve, Termave të referencës dhe Specifikimeve teknike, si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Liçencën profesionale të shoqërisë është e nevojshme prania e inxhinierit të ndërtimit, inxhinierit hidroteknik, inxhinierit elektrik, inxhinierit mekanik, inxhinierit topograf, inxhinierit elektronik.

- 2.3.4. Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë nga (Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe që do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera., apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Vendosja e këtij kriteri mbështetet në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4.1, ku përcaktohet se: *“drejtimi i kantierit sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga sipërmarrësi ose nga drejtuesit e kantierit (drejtori i punimeve/përgjegjësi teknik i kantierit), që emërohen prej tij. Në rastet kur drejtuesi ligjor e teknik i sipërmarrësit nuk udhëheq drejtpërdrejt punimet në kantier njoftohet, zyrtarisht, investitori për drejtuesit e punimeve dhe personat e tjerë, të emëruar me detyrë në kantier”.*

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndaloheq të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit”* dhe pika 2: *“elementët e licensës”* gërma “c” ku citohet se: *“Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.*

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si me poshte:

- 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”.
- 1 (një) Inxhinier i kualifikuar sipas EN ISO 9712, Inspektor NDT Niveli II, për inspektime VT, UT, MT, RT.
- 1 (një) punonjës i certifikuar për inspektimin me termografi (kamera termike), i pajisur me certifikatën e kualifikimit sipas EN ISO 18436-7:2014.
- 1(nje) punonjes i kualifikuar sipas EN ISO 14731, Specialist Ndërkombëtar Saldimesh (IWS)
- 8 (tete) punonjës Saldatore të certifikuar sipas standartit EN ISO 9606-1 :2017
- 10 (dhjete) punonjës te certifikuar per Punimet në lartësi
- 3(tre) inxhinierë/Specialiste të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike Teknologji Informacioni / Telekomunikacion
- 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi në sisteme Operimi OS (operating system), të nivelit associate ose system administrator, ose ekuivalent.

- 1 (një) punonjës që disponon kualifikim: “ExF” për njohuritë për ndërgjegjësimin e zonave me rrezikshmëri”, për këtë duhet të paraqitet çertifikata e trajnimit e lëshuar nga një organ i akredituar, i huaj ose shqiptar.
- 1 (një) punonjës të çertifikuar në Networking të nivelit associate. Çertifikimet duhet të jenë të lëshuara nga vendori Cisco, Juniper, Fortinet, ose ekuivalent.

**Për secilin punonjës duhet të paraqiten:**

- Kontratë individuale pune e vlefshme.
- Diploma e arsimit të lartë/ certifikata përkatëse.
- Listepagesat e shoqërisë për të pakten muajin e fundit në të cilat punonjësit e sipërpermendur duhet të figurojnë.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e inxhinierëve dhe punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8. Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

**Argumentimi** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" Neni 7 .... Sherbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit ... 1. Punedhenesi ngarkon një ose disa punëmarres që të merren me ceshtjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndermarrje /institucion ...., dhe V.K.M nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier".

Kërkesa për 1 (një) Inxhinier i kualifikuar sipas EN ISO 9712, Inspektor NDT Niveli II, për inspektime VT, UT, MT, RT. Duke iu referuar kërkesave të standardeve të harmonizuara shqiptare përkatësisht për projektimin, ndërtimin e depozitave mbitokësore S SH EN 14015:2004 dhe projektimin e ndërtimit të strukturave metalike S SH EN 1090-2, paraqitet kërkesa e inspektimit të saldimeve të realizuar me metoda pa shkatërrim si testim vizual (VT), testim me grimca magnetike (MT), testim me ultratinguj (UT) e testim me radiografi (RT), për të konfirmuar cilësinë e saldimeve dhe evituar defekte të ndryshme. Në këto kushte, inxhinieri që realizon këto inspektime duhet të jetë i kualifikuar sipas standardit të harmonizuar shqiptar S SH EN ISO 9712.

Kërkesa për 1 (një) punonjës i certifikuar për inspektimin me termografi (kamera termike), i pajisur me certifikatën e kualifikimit sipas EN ISO 18436-7:2014. Sipas kërkesave të objektit të prokurimit, nevojitet instalimi i impianteve që zhvillojnë temperaturë. Në këto kushte, për shkak të rregullave të shëndetit dhe sigurisë në punë, për vlerësimin e punës së këtyre impianteve nëse kanë arritur temperaturën, është e nevojshme inspektimi me kamera termike e këtyre instalimeve.



Kështu, standardi i harmonizuar shqiptar S SH EN ISO 18436-7:2014 paraqet kërkesa specifike për stafin e angazhuar në këtë inspektim, ku stafi duhet të jetë i certifikuar sipas kërkesave të këtij standardi.

Kërkesa për 1 (nje) punonjes i kualifikuar sipas EN ISO 14731, Specialist Ndërkombëtar Saldimesh (IWS). Sipas standardit S SH EN 3834 dhe S SH EN 1090, OE i certifikuar sipas këtyre standardeve duhet të ketë të angazhuar me kohë të plotë në Specialist Ndërkombëtar Saldimesh – IWS, i certifikuar sipas S SH EN ISO 14731, i cili garanton përmbushjen e kërkesave sipas standardeve të sipërcituar.

Kërkesa për 8 (tete) punonjës Saldatore të certifikuar sipas standartit EN ISO 9606-1 :2017. Kjo kerkese është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, keta punonjes jane te domozdoshem bazuar ne rendesine e objektit si dhe per te garantuar cilesi dhe eficence te larte nisur nga fakti qe te gjithë bashkimet me saldime do te kryhen vetem permes saldimeve te cilat duhet te jene ne perputhje me EN ISO 9606-1 :2017.

Kërkesa për 10 (dhjete) punonjës te certifikuar per Punimet në lartësi. Kjo kërkesë eshte ne perputhje me tipologjine e objektit te prokurimit pasi parashikohen punime në lartësi të depozitave dhe si rezultat i kësaj rënia nga një lartësite e individëve apo materialeve përbën rrezik shumë të madh për jetën dhe shëndetin e personave të pranishëm në objekt.

Kërkesa për 3 (tre) inxhinierë/Specialiste të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike Teknologji Informacioni / Telekomunikacion. Kjo kërkesë eshte ne perputhje me tipologjine e objektit te prokurimit dhe për pajisjet që do të instalohen dhe konfigurohen nevojiten ekspertiza dhe njohuritë e inxhinierëve të sipërcituar.

Kërkesa për 1 (një) punonjës të certifikuar nga prodhuesi në sisteme Operimi OS (operating system), të nivelit associate ose system administrator, ose ekuivalent. Kjo kërkesë eshte ne perputhje me tipologjine e objektit te prokurimit. Punonjësi duhet të ketë njohuri rreth sistemeve operative mbi të cilat do të instalohen softet përkatëse.

Kërkesa për 1 (një) punonjës që disponon kualifikim: “ExF” për njohuritë për ndërgjegjësimin e zonave me rrezikshmëri”, për këtë duhet të paraqitet certifikata e trajnimit e lëshuar nga një organ i akredituar, i huaj ose shqiptar. Kjo kërkesë eshte ne perputhje me tipologjine e objektit te prokurimit. Punonjësi i cili posedon këtë certifikatë është i trajnuar posacërisht mbi ndërgjegjësimin dhe menaxhimin e rrezikut në zona specifike, sic është stacioni i shitjes së naftës në Zharrëz.

Kërkesa për 1 (një) punonjës të çertifikuar në Networking të nivelit associate. Çertifikimet duhet të jenë të lëshuara nga vendori Cisco, Juniper, Fortinet, ose ekuivalent. Punonjësi i sipërcituar duhet që të konfigurujë rrjetin në mënyrë që pajisjet të komunikojnë me njëra tjetrën.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 100 (njëqind) persona minimumi per muajin e fundit.

Per kete te paraqitet:

- Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për minimalisht muajin e fundit.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e fuqisë punëtore në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

**Argumentimi:** Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 100 persona, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar si staf teknik per kryerjen e punimeve, konkretisht minimumi:

- 2 (dy)Teknik Ndertimi
- 1 (nje)Teknik Gjeometer/topograf
- 1 (nje)Teknik Mekanik
- 5 (pese) Karpentiere
- 5 (pese) Hekurkthyes
- 2 (dy) Hidraulike
- 1 (nje) Kaldaist
- 4 (kater) Elektriciste
- 2 (dy) Elektroteknike
- 1 (nje) Elektromekanik
- 4 (kater) Mekanike
- 5 (pese) Automakiniste
- 4 (kater) Eskavatoriste
- 1 (një) Buldozerist
- 8 (tete) Drejtues mjeti (shofere)
- 3 (tre) Vincier

**Për keta punonjes, ofertuesi duhet të paraqesë :**

- Kontratë individuale pune e vlefshme;
- Një dokument (Diplomë/certifikate profesionale), që vërteton nivelin e kualifikimit profesional, lëshuar nga institucione publike/private, të licencuara/akredituara, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Listepagesat e shoqërisë për të paktën muajin e fundit në të cilat punonjësit e sipërpermendur duhet të figurojnë.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Pjesa 3, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mesipër, emer/mbiemer, profili i punës, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri dhe titulli i kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument, ose të plotësojnë tabelën e mëposhtme :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr i amzës/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj					

- Për Manovratorët të paraqiten deshmite e aftësisë profesionale nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme dhe të figurojnë në listepagesa për të paktën muajin e fundit ose kur mjetet disponohen me qira manovratorët mund të disponohen së bashku me mjetet e mara me qira, (të kontraktuar me kontratë pune) pa pasur nevojë të jenë të përfshirë në listepagesat e operatorit ekonomik ofertues.

- Per shoferet të paraqitet leje drejtimi e vlefshme dhe te figurojne ne listepagesa për për të paktën muajin e fundit ose kur mjetet disponohen me qira drejtuesit e mjeteve mund te disponohen së bashku me mjetet e mara me qira, (të kontraktuar me kontratë pune) pa pasur nevojë te jene te perfshire ne listpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

**Argumentim.** Në kriterin mesiperm është kërkuar që OE të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e punimeve. Përcaktimi i numrit të punonjësve dhe profesionet janë bazuar mbi zerat dhe volumet e punës si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të Manualit të ndertimit miratuar me Vendim nr.629, date 15.07.2015 (*Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018*). Bazuar në kriter elementet e struktures së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore. Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogun/skedë teknike të prodhuesit për pajisjet elektronike për produktet hardware që janë objekt prokurimi. Katalogu/skeda teknike të përmbajë karakteristikat teknike të produkteve hardware me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produktet e ofruar plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. (Pjesët specifike të katalogut ku jepen karakteristikat e produktit hardware nëq nuk janë në gjuhën shqipe të perkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe AK të sigurohet se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre produkteve. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe se mallrat e ofruara janë konform të gjitha standarteve dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.9. Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 15 ton	në pronësi ose me qira	Copë 3
2	Kamion me Vinc me kapacitet mbajtës 7.5-18 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
3	Autovinc me kosh me krah mbi 10m	në pronësi ose me qira	Copë 2
4	Autovinc me kapacitet ngrites jo me i vogël se 40 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
5	Buldozier	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Fadrome me Goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Eskavator me zinxhirë	në pronësi ose me qira	Copë 1
10	Minieskavator me zinxhirë	në pronësi ose me qira	Copë 1
11	Sistemi Well-Point i pajisur me pompe thithese, kolektor dhe aksesori bashkues	në pronësi ose me qira	Copë 1
12	Motokompresor mbi 10bar	në pronësi ose me qira	Copë 2
13	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
14	Aparat saldimit për saldimit me hark të zhytur (SMAW)	në pronësi ose me qira	Copë 5
15	Aparat saldimit me tel saldimit (MIG/MAG) 300÷500A	në pronësi ose me qira	Copë 4
16	Makineri pastrimi me rere abrazive	në pronësi ose me qira	Copë 1
17	Rul vibrues gomë-hekur	në pronësi ose me qira	Copë 1
18	Rrul vibrues asfalti hekur-hekur	në pronësi ose me qira	Copë 1
19	Minifadrome	në pronësi ose me qira	Copë 1
20	Autobot uji mbi 5000 litra	në pronësi ose me qira	Copë 1
21	GPS	në pronësi ose me qira	Set 1
22	Asfaltoshtuese	në pronësi ose me qira	Copë 1
23	Autobitumatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1
24	Traktor Saldimit MIG/MAG	në pronësi ose me qira	Copë 2
25	Kalander llamarine	në pronësi ose me qira	Copë 1
26	Sharrë për prerjen e profileve metalike	në pronësi ose me qira	Cope 1
27	Plazma CNC për prerje metali	në pronësi ose me qira	Copë 1
28	Automjet teknologjik e pajisur me pompe vakumi për thithje llumi	në pronësi ose me qira	Copë 1
29	Trapano bango për punimin e pllakave/profileve metalike	në pronësi ose me qira	Copë 1
30	Impiant Betoni	në pronësi / me qira ose kontrate furnizimi	Copë 1
31	Autobot për transportin e mbetjeve vajore me kapacitet min. 5000 litra	në pronësi ose me qira	Copë 1

32	Mjete transporti me kontenier për transportin e mbetjeve të rrezikshme	në pronësi ose me qira	Copë 1
33	Total station	në pronësi ose me qira	Copë 1
34	Kamera termike me diapazon matje -20 ÷ +250 °C	në pronësi ose me qira	Copë 1
35	Pajisje me ultratinguj për detektimin e defekteve për provat pa shkatërrim të saldimeve për strukturat metalike për trashësi deri në 60mm (UT Flaw Detector – NDT)	në pronësi ose me qira	Copë 1
36	Pajisje për matjen e trashësisë së sipërfaqeve metalike me ultratinguj (UT thickness gauge)	në pronësi ose me qira	Copë 1
37	Manometër / matës presion digjital ose analog për matje deri në 200 bar	në pronësi ose me qira	Copë 1
38	Magnetizues për inspektimin e saldimit	në pronësi ose me qira	Copë 1
39	Gjenerator rrezesh X – K 250 KV	në pronësi ose me qira	Copë 1
40	Pajisje për matjen e trashësisë së bojës në të thatë, me diapazon matje 0 ÷ 30mm	në pronësi ose me qira	Copë 1

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit:-leja e qarkullimit; -çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin dhe fotot perkatese;
- b) Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipërme, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirave e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plote të punimeve.
- c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipërme, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirave e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plote të punimeve.
- d) Për pajisjet ngritëse sipas numrave rendorë 2, 3, 4 duhet të paraqitet raporti i vlefshëm i inspektimit të tyre.
- e) Për pajisjet e inspektim/verifikimit me numrat rendorë 33, 34, 35, 36, 37 duhet të paraqitet certifikatë e vlefshme e kalibrimit.
- f) Të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara të jenë të shoqëruara me foto.
- g) Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetesinë e deklaratës dhe verifikimin e makinerive dhe pajisjeve në terren.
- h) Mjetet dhe pajisjet e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet “Deklaratë” nga administratori i shoqërisë ofertuese. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.



**Shenim:** Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.10. Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

- ISO 9001: 2015 (Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.*
- ISO 14001: 2015 (Sistemet e Menaxhimit Mjedisor) ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.*
- ISO 45001: 2018 (Sistemet e Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë) ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.*
- ISO 50001: 2018 (Sistemet e Menaxhimit të Energjisë) ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.*
- ISO 27001: 2015 (Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit) ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anëtari që do të kryejë punimet e perkatëse*
- ISO 3834-2:2021 (Kerkesat e cilësisë për saldimin e materialeve metalike) ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anëtari që do të kryejë punimet e perkatëse.*

- EN 1090-2: 2018 (Kërkesat e cilesise per realizimin e konstruksioneve prej alumini dhe celiku), ose ekuivalent. *Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga anetari qe do te kryeje punimet e perkatese.*

**Shenim:** Ne paraqitjen e certifikatave ISO ne cdo rast do te pranohen edhe variantet e perditesuara te ketyre certifikatave (nese do te paraqiten).

**Argumentim::** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë dhe sistemi i menaxhimit të energjisë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Kërkesa per ISO 27001: 2015 eshte ne perputhje te plote me parashikimet ne termat e references dhe specifikimet teknike, lidhur me pajisjet dhe softet qe do te instalohen dhe konfigurohen.

Kërkesat për ISO 3834-2:2021 dhe EN 1090-2: 2018 janë në përputhje të plotë me objektin e prokurimit pasi në termat e referencës dhe specifikimet teknike janë parashikuar punime me saldimit si dhe ndërtim i disa rezervuarëve metalikë. Standartet e cituara përcaktojnë kërkesat e cilesise per saldimitin e materialeve metalike.

2.3.11. Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë Licencë për aktivitet me burime rrezatimi jonizues, lëshuar nga Autoritetet perkatese.

**Argumentimi:** Kërkesa eshte parashikuar bazuar ne termat e references dhe specifikimet teknike. Sipas Vendimit Nr. 10 dt. 07.01.2010 – Për Miratimin e Rregullores “Për Licensimin dhe Inspektimin e veprimtarive me burim të rrezatimeve jonizuese”, të nenit 9, të ligjit nr.8025, datë 9.11.1995, "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", të ndryshuar, dhe të nenit 5, të ligjit nr.10081, datë23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, pika 3. Liçensimi, OE i cili detyrohet të ushtrojë aktivitetet me rrezatime jonizuese (inspektimet e saldimeve me radiografi) është i detyruar të paraqesë licensë për aktivitet me burimet jonizuese.

2.3.12. Operatori ekonomik për vlerësimin e konformitetit, duhet të paraqesë aktin e miratimit si organ i miratuar për vlerësimin e konformitetit, lëshuar nga Ministria e Industrisë dhe Energjisë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet mbështetur në: Ligj Nr. 10489, datë 15.12.2021 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore” i ndryshuar, Urdhrin e Ministrit nr. 53, datë 05.10.2017 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat e miratimit dhe mbikëqyrjes së organeve europiane të notifikuara dhe organeve të miratuar të vlerësimit të konformitetit”, ku OE pasi të realizojë objektin e prokurimit, bazuar ne termat e references, duhet të kryejë vlerësimin e konformitetit të instalimeve e depozitave të naftës bruto, ku operatori që do të angazhohet për këtë vlerësim, duhet të jetë një organ i miratuar i vlerësimit të konformitetit, nga Minsitria përkatëse.

2.3.13. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) kategoria III.2.B për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim, rikuperim të mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

2.3.14. Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B Grumbullim, Transportim, Ruajtje, e mbetjeve të llojeve të ndryshme të rrezikshme dhe ujërave të ndotur.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendim Nr. 538 date 26.05.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa”, si dhe ne permbushje te detyrimeve ligjore qe percakton Ligji 10431 date 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (të ndryshuar).

Ky kriter synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, dhe mbetjeve te rrezikshme, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin, magazinimin, asgjësimin, të cilat cojnë në pakësimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të demshme. Duke qenë se në preventivin e punimeve janë pasqyruar punime prishje, gërmimi, transport, është gjuvuar që subjekti duhet të ketë lejen e posaçme për veprimtari të tilla si Stacionim transferimi për mbetjet nga prishjet dhe ndërtime, për mbetjet e ngurta, mbetjet e rrezikshme dhe magazinim i përkoshëm i tyre.

Me anë të këtyre kriterëve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat/lejet profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e proceseve te punës të parashikuara në kontratë, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

2.3.15. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Grafikon e punimeve të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumantat e tenderit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.16. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **deklaratën** ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues). Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar, pasi financimi është parashikuar sipas programit të zhvillimit të shoqërisë edhe pse afati i realizimit është sipas grafikut të punimeve.

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Specifikimet teknike janë hartuar nga Projektuesi i cili ka njohuri të posacme për objektin e prokurimit, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

**Shënim:** Në të gjitha rastet në specifikime teknike ose preventiv ku mund të jenë përmendur markë specifike apo emërtim AK ka parashikuar se do të pranohen edhe ekuivalentët e tyre.

**Shënim:** Në të gjitha rastet ku në Dokumentat e tenderit, specifikimet teknike ose preventiv përmenden standarte ndërkombëtare Ak, ka parashikuar se do të pranohen edhe standartet kombëtare të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA).

## Njësia e Prokurimit: